



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

OSNOVNI SUD PRIŠTINA - OGRANAK GRACANICA

Broj predmeta: 2023:258653

Datuma: 08.10.2024

Broj dokumenta: 06269571

K.nr.510/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA GRAQANICE - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, në përbërje të gjyqtarit individual Siniša Borisavljević, me bashkepunetoren profesionale Pranvera Ismaili Zhinipotoku, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit **R. S.** nga Istogu për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 53.1 dhe neni 255, par. 2, të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088), më datë 14.08.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Te pandehurit **R.S**, me numer personal i lindur më dt. 14.12.1984. në f.Studenic K.Istog, me vendbanim ne në f. Studenic K.Istog ,rr. ,Qazim Hakaj,, nr.193, ka te kryer sh.e mesme , i martuar, gjendjes së mesme ekonomike, i pa denuar me pare, Shqiptar, shtetas i R. Kosovës,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse: Me datën 17.10.2023rreth rreth orës 13.25, ka ardh deri te aksident trafiku kur drejtuesi i automjetit "A" ka qen duke lëvizur ne rrugën Prishtin Gjilan Drejtuesi i Automjetit Toyota Land Crusser duke mos e mbajt distancen mes Automjeteve e godet veturen Vw Bora me pjesen e parme ne pjesen e mbrapse me rast shkakton Aksident trafiku me deme materiale dhe lendime

- me çka ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 53.1 dhe neni 255, par. 2, të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088),për rrjedhojë gjykata duke vendosur në kuptim të nenit në fjalë si dhe në bazë të neneve 3, 7, 8, 9, 13, 27, 29 dhe 35 të ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, ky Aktgjykim i shqiptohet të pandehurit ku:

D Ë N O H E T

ME DËNIM ME TË HOLLA në shumë prej 200 € (dyqindeuro), per vepren e kryer e cila i vihet ne barre si me larte.

Miratohet qe te paguhet gjoba ne dy keste të barabarta prej **100 euro** secila, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për përmbarim.

Gjoben e shqiptuar I pandehuri do ta paguaj ne afate prej **15** dite nga dita e kur aktgjykimi te merre formen e prere , nene kerccenim te permbarimit ne perputhje me dispozitat LPP-s.

I pandehuri, obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **5 € (pese euro)** në afatin e njëjtë . Nga një kopje të këtij aktgjykimi ti dërgohet të pandehurit, ushtruesit të kërkesës dhe te demtuarit.

A r s y e t i m i

Stacioni Policor-NJRKRR në Prishtinë e, kësaj Gjykate i ka parashtruar Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse **nr.2023-AR-3276 datë 17.10.2023** e cila ne gjykat eshte pranuar me dt.01.06.2023 , kundër të pandehurit të lartëshenuar, për shkak të veprës kundërvajtëse e pershkruar sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari, filloi procedurën kundërvajtëse, marrjes në pyetje të pandehurin e cila në deklaratën-mbrojtjen e tij me dt 09.08.2024 , në tërësi pranoi veprën kundërvajtëse e cila i ngarkohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj për këtë nuk pati nevojë që të administrohen prova tjera

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehurit si dhe kërkesën e stacionit policor, gjyqtari i çështjes erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse , ashtu që të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, gjyqtari muarr parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 35 të Ligjit për Kundërvajtje e sidomos peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, shkallën e përgjegjësisë dhe tiparet personale të tij , pranimin e fajsisë, është penduar dhe ka premtuar se nuk do t'a përsëris mënjë veprim të tillë si dhe faktin se deri me tani nuk ka qene i denuar , andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurit iu shqiptua një dënim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Ne baze të të gjitha te cekurave më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA GRAQANICE

Departamenti i pergjithshem, Divizioni per kundervajtje

K.nr 510/23 nga 14.08.2024

Bashkepunetore Profesionale
Pranvera Ismaili Zhinipotoku

Gjyqtari
Siniša Borisavljević

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtroj ankesë paraqitësi i kërkesës dhe i pandehuri, në afat prej **8 ditësh** nga dita e pranimit të aktgjykimit në Gjykatën e Apelit- Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.